

VENDIM
Nr. 410, datë 4.7.2018

**PËR CAKTIMIN E MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË SI
ORGANIN E INTERESUAR DHE AUTORIZIMIN E SAJ PËR TË LIDHUR SHITESË
KONTRATE, NËPËRMJET AVOKATURËS SË SHTETIT, ME FIRMËN AVOKATORE
“GOWLING WLG”, PËR PËRFAQËSIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
ÇËSHTJEN E ARBITRAZHIT NDËRKOMBËTAR KUNDËR SHOQËRISË “HYDRO
S.R.L.”,
ICC 22919/GR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 7; 5, pika 1, shkronja “b”; 12, pikat 2 e 6; 15, pika 8, dhe 18, pika 2, të ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si organin e administratës publike të interesuar në çështjen e arbitrazhit kundër shoqërisë “Hydro S.R.L.”.
 2. Autorizimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë që, nëpërmjet Avokaturës së Shtetit, të lidhë shitesë kontrate me firmën avokatore ndërkombëtare “Gowling WLG” për përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar të iniciuar nga shoqëria “Hydro S.R.L.”, ICC 22919/GR, të negociuar nga Avokatura e Shtetit, me vlerë të përgjithshme 950 000 (nëntëqind e pesëdhjetë mijë) euro.
 3. Shtesa e kontratës të rregullojë përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar kundër shoqërisë “Hydro S.R.L.”
 4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë dhe Avokatura e Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama